



National Council for
Economic Development

COVID-19: IMPLIKIMET LIGJORE PËR BIZNESET

Prishtinë, Prill 2020

Covid-19: Implikimet ligjore për bizneset

Pandemia e shkaktuar nga Coronavirus COVID-19 është duke pasur një ndikim të vazhdueshëm në ekonominë globale dhe veçanërisht në aktivitetet e biznesit. Organet qeveritare janë duke miratuar politika për mbylljen apo kufizimin e bizneseve dhe lëvizjen e njerëzve, gjë e cila do të ketë ndikime të mëdha në veprimtarinë ekonomike të vendit, ku shumë biznese në vend do të përballen me pasoja të rënda tregtare, siç janë vonesat në shpërndarjen e mallrave dhe shërbimeve, të cilat rrjedhimisht ndikojnë në përmbushjen e detyrimeve të kontraktuara. Prandaj, pavarësisht përpjekjeve bizneset do të hasin në vështirësi gjatë përmbushjes së kontratave të tyre, si tek kontratat komerciale, po ashtu edhe tek kontratat publike.

Kontratat Komerciale

Kontratat komerciale janë marrëveshje të lidhura ndërmjet dy ose më shumë subjekteve afariste për ndonjë çështje komerciale, përmes të cilave palët janë të obliguar të përmbushin detyrimet e tyre. Këto kontrata kanë të bëjë me qarkullimin e mallrave dhe dhënien e shërbimeve. Në përgjithësi, kontratat janë të lidhura në formën me shkrim, ku palët vënë nënshkrimin e tyre dhe datën e lidhjes së kontratës. Nëse në kontratën dypalëshe një palë nuk përmbush detyrimet e saj, pala tjetër mund të kërkojë përmbushjen e detyrimeve ose të tërhiqet nga kontrata dhe kështu të kërkojë zgjidhjen e kontratës. Si rrjedhojë, pala e dëmtuar mund të kërkojë shpërblimin e dëmit si dhe fitimin e munguar për shkak të mospërmbushjes së kontratës ose vonesës në përmbushjen e kontratës. Nisur nga më sipër, për shkak të situatës me Covid-19, kushte të përgjithshme ose të veçanta të kontratës mund të mospërmbushen nga palët, kështu që kreditori mund të parashtojë kërkesë për sa i përket mospërmbushjes së detyrimeve ose të kërkojë zgjidhjen e mosmarrëveshjes komerciale në gjykatën kompetente ose në arbitrazhin për të cilin janë pajtuar palët qysh më parë dhe për pasojë mund të kërkojë shpërblimin e dëmit dhe fitimin e munguar. Kur përballen me konteste juridike komerciale për sa i përket përmbushjes së detyrimeve të palëve në kontratat komerciale, gjykata ose arbitrazhi mund të zbatojë ligjet e brendshme ose ligjin ndërkombëtar, si pasojë e ligjit që rregullon kontratën e lidhur ndërmjet palëve. Kontratat ndërkombëtare ndërmjet subjekteve afariste rregullohen me ligjin të cilin janë rënë dakord palët qysh më parë.

Ndërsa, kontratat ndërmjet subjekteve afariste vendore rregullohen nga ligjet e brendshme. Ky raport nxjerr në pah disa çështje që bizneset në vendin tonë duhet të jenë të vetëdijshëm në rast të mosmarrëveshjeve si rezultat i mospërbushjes së detyrimeve të kontraktuara.

Identifikimi i Ligjit

Para së gjithash, palët e goditura duhet të identifikojnë ligjin që rregullon kontratën e tyre për të vlerësuar se si Covid-19 mund të ndikojë në marrëdhëniet e tyre të kontraktuara dhe se si interpretohen kontratat e tyre komerciale, përfshirë klauzolat e "force majeure/fuqisë madhore".

Force Majeure/Fuqia Madhore

Palët kontraktuese duhet të rishikojnë me kujdes kushtet e kontratës, përfshirë këtu "force majeure/fuqinë madhore" dhe detyrën e njoftimit, si dhe të jenë vigjilentë për të rënë dakord për një ndryshim apo tërheqje nga detyrimet e përcaktuara të kontraktuara pa vullnetin e tyre.

Së pari, në rast të kontesteve të mundshme komerciale midis bizneseve, palët duhet të identifikojnë nëse një klauzolë e "force majeure" përfshihet në kontratën e tyre. Pra, bizneset private mund të gjejnë nëse dhe në çfarë mase "force majeure" përfshihet në kontratat e tyre. Legjislacioni i Kosovës nuk e definon nocionin "force majeure" e cila do t'i lejonte palët në një kontratë komerciale të shmangin përbushjen e detyrimeve të tyre të kontraktuara në rast të mbizotërimit të një ngjarjeje që mund t'i ndryshoj ato.

Koncepti i "force majeure" nënkupton një ngjarje apo rrethanë anormale, e paparashikueshme dhe e pashmangshme, përtej kontrollit të palëve kontraktuese, pasojat e të cilave nuk mund të ishin shmangur pavarësisht ushtrimit të gjithë kujdesit të duhur. Në mënyrë që një ngjarje të cilësohet si "force majeure" duhet të plotësoj tre elemente: ngjarja duhet të jetë përtej kontrollit të arsyeshëm të palës së prekur; aftësia e palës së goditur për të përbushur detyrimet e saj sipas kontratës duhet të ishte parandaluar nga ngjarja dhe pala e prekur duhet të ketë ndërmarrë të gjitha hapat e arsyeshëm që të kërkoj për të shmangur ose për të zbutur ngjarjen ose pasojat e saj. Palët janë të lira të zgjedhin një përkufizim më të gjerë ose më të ngushtë të "force majeure", të përfshijnë një listë të ngjarjeve të konsideruara si të tilla dhe të bien dakord për pasojat e

“force majeure” në marrëdhëniet e tyre të kontraktuara, për shembull për të pezulluar dhe rinegociuar kontratat ose të ndërpresin kontratën duke u kompensuar paraprakisht. “Force majeure” mund të përfshijë një listë të ngjarjeve si: luftën, trazirat, zjarrin, përmbytjen, tërmetin, shpërthimin, grevat, dhe akte veprimesh shtetërore ose qeveritare, duke ndaluar ose penguar cilëndo palë në përmbushjen e detyrimeve përkatëse të kontraktuara.

Lidhur me çështjen se nëse pandemia globale (Covid-19) do të cilësohej si “force majeure”, me qëllim mbrojtjen e palëve të prekura për mospërmbushjen e detyrimeve të tyre të kontraktuara, kryesisht varet nga formulimi i klauzolës “force majeure”, se si është përcaktuar në kontratë. Kontratat komerciale ndërkombëtare zakonisht përfshijnë klauzolën e fuqisë madhore, gjë që nuk e gjejmë edhe te kontratat komerciale vendore në Kosovë.

Për më shumë instituti i “Force Majeure” vërehet edhe në Ligjin nr. 04/L-176 për Turizmin, përmes të cilit bizneset që ofrojnë shërbime turistike mund të gëzojnë mbrojtje ligjore duke u thirrur në “force majeure”, për sa i përket anulimit të paketave turistike dhe dëmeve që organizatori ose ndërmjetësuesi mund t’iu shkaktojnë konsumatorëve si pasojë e mospërmbushjes së detyrimeve të tyre. Kështu që, përmes Ligjit nr. 04/L-176 për Turizmin organizatori ose ndërmjetësuesi lirohet nga përgjegjësia për: a) kompensimin e shumës së paguar konsumatorit në rast të anulimit të paketës së kontraktuar nga ana e organizatorit ose ndërmjetësuesit kur anulimi, është për arsye të fuqisë madhore (mirëpo nuk do lirohen nga përgjegjësia për zëvendësimin e paketës turistike të kontraktuar, me paketë të cilësisë ekuivalente ose më të lartë), dhe b) dëmin që i shkaktohet konsumatorit nga dështimi për të përmbushur kontratën nga ana e organizatorit ose ndërmjetësuesit, kur dështimi i tillë vjen si pasojë e fuqisë madhore.

Në rastet kur klauzola “force majeure” nuk përfshihet në kontratat e lidhura ndërmjet palëve, atëherë palët e goditura mund të mbrohen nga parimet e përgjithshme të ligjit civil-juridik, duke përfshirë parimin e zgjidhjes ose revidimit të kontratës për shkak të rrethanave të ndryshuara (rebus sic stantibus) dhe pamundësinë e përmbushjes, që sikurse “force majeure” përbëjnë klauzolat të cilat lirojnë ose kufizojnë përgjegjësinë e njëres palë kontraktuese në rastet kur pala kontraktuese nuk ka mundur të përmbushë detyrimet e veta për shkak të rrethanave të shkaktuara jashtë vullnetit dhe kontrollit të tyre.

Zgjidhja ose revidimi i kontratës për shkak të rrethanave të ndryshuara (*Rebus sic stantibus/prezumimi i zgjidhjes*)

Ndonjëherë, pas lidhjes së kontratës, mund të lindin rrethana pa fajin e palëve, të cilat palët nuk kanë mundur t'i parashikojnë, pengojnë apo eliminojnë, kështu që ua bëjnë të pamundur përmbushjen e detyrimeve. Parimi i zgjidhjes ose revidimit të kontratës për shkak të rrethanave të ndryshuara nënkupton parimin që në rast se ka pasur një ndryshim thelbësor të rrethanave, një palë mund të tërhiqet nga kontrata ose të kërkojë të zgjidhë atë, por mund të kërkojë që edhe të ndryshohet me pajtimin e palës tjetër, ashtu që të mundësohet përmbushja e kontratës. Një gjë e tillë është e parashikuar nga neni 116 i ligjit nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve më saktësisht në kapitullin e IV të tij "Zgjidhja ose revidimi i kontratës për shkak të rrethanave të ndryshuara" ku ceket se "Në qoftë se pas lidhjes së kontratës krijohen rrethanat që e vështirësojnë përmbushjen e detyrimit të njëjës palë, apo në qoftë se për shkak të tyre nuk mund të realizohet qëllimi i kontratës,, pala të cilës i është vështirësuar përmbushja e detyrimit, përkatësisht pala e cila për shkak të rrethanave të ndryshuara nuk mund ta realizojë qëllimin e kontratës, mund të kërkojë që kontrata të zgjidhet apo të ndryshohet". Që të mund të shkëputet ose të ndryshohet kontrata për shkak të ndryshimit të rrethanave, duhet të përmbushen këto kritere: kontrata të jetë me detyrime të dyanshme; rrethanat të jenë shkaktuar pas lidhjes së kontratës; rrethanat e shkaktuara t'ia vështirësojnë njëjës palë përmbushjen e detyrimeve ose që për shkak të tyre nuk mund të realizohet qëllimi i kontratës dhe kontrata e lidhur qartazi më nuk i përgjigjet asaj që kanë pritur palët. Pala e cila për shkak të rrethanave të ndryshuara nuk mund të realizojë qëllimin e kontratës, mund të kërkojë që kontrata të zgjidhet ose të ndryshohet nëse pala tjetër pranon që kushtet të ndryshohen, ashtu që mundësohet përmbushja e kontratës. Zgjidhja ose ndryshimi i kontratës nuk mund të kërkojë, në qoftë se pala që i referohet rrethanave të ndryshuara ka pasur për detyrë në kohën e lidhjes së kontratës t'i merrte parasysh këto rrethana ose ka mundur të mënjanojë apo t'i përballojë ato. Sidoqoftë, pala e goditur me rrethanat e ndryshuara që synon të kërkojë zgjidhjen e kontratës, ka për detyrë të njoftojë palën tjetër për qëllimet e saj menjëherë pasi të ketë mësuar për rrethanave të reja, në të kundërtën pala e goditur do të konsiderohet përgjegjëse për dëmin që ka pësuar pala tjetër, për shkak të dështimit që të njoftonte me kohë në lidhje me kërkesën.

Pamundësia e Përbushjes

Në rast se detyrimet të kontraktuara nuk mund të përmbushen nga palët, për shkak se kanë lindur rrethana që palët nuk kanë mundur t'i parashikojnë, t'i pengojnë apo t'i eliminojnë, atëherë këto detyrime shuhen. Pamundësia e përmbushjes për të cilën nuk përgjigjet asnjë palë parashihet në Ligjin për Marrëdhëniet e Detyrimeve, e në veçanti Neni 120 parasheh që në rast se përmbushja e detyrimit të njëjës palë është bërë e pamundur për shkak të ngjarjes për të cilën nuk është përgjegjëse asnjëra palë, shuhet edhe detyrimi i palës tjetër, e në qoftë se pala ka përmbushur diçka prej detyrimit të vet, mund të kërkojë kthimin sipas rregullave për kthimin e pasurimit të pabazë. Sipas ligjit një kontratë konsiderohet e zgjidhur për shkak të pamundësisë së përmbushjes dhe kështu pala lirohet nga detyrimi i saj nëse ekzistojnë këto elemente: pamundësia e përmbushjes së detyrimit dhe mungesa e fajit të palës në lidhje me ngjarjen që e bëri të pamundur përmbushjen.

Bazuar në më sipër, duhet theksuar se të gjitha sistemet juridike parimisht pranojnë që debitori mund të lirohet nga përgjegjësia për mospërmbushjen e detyrimit, në rast se kjo mospërmbushje është shkaktuar nga rrethana mbi të cilat ai nuk ka mundur të ndikojë dhe të cilat janë paraqitur pa fajin e tij.

Kontratat e Prokurimit Publik

Kontratat e prokurimit publik janë kontratat me interes financiar të lidhura midis një apo më shumë operatorëve ekonomikë në një të njëjtën anë dhe një apo më shumë autoriteteve kontraktuese në anën tjetër, me qëllim të ekzekutimit të punimeve, furnizimit me mallra ose ofrimit të shërbimeve, për të mirën e komunitetit e të financuara nga fondet qeveritare. Për sa i përket përfshirjes së klauzolës "force majeure në këto kontrata, duke iu referuar një draft kontrate publike kornizë në Kosovë në verzionin në gjuhën angleze, vërejmë se ajo përmban klauzolën e "force majeure" dhe nën kushtet e përgjithshme parasheh epidemitë si një "force majeure"; dhe detyron operatorin ekonomik të sigurojë një deklaratë me shkrim dhe informacion të plotë në lidhje me ngjarjen, në rast të pamundësisë që kontraktuesi të përmbushë detyrat dhe përgjegjësitë në bazë të kontratës.

Më saktësisht, Neni 11 i kontratës kornizë parasheh se "operatori ekonomik mund të kërkojë zgjatje të periudhës së ekzekutimit nëse realizimi i kontratës së tij vonohet, ose pritët se do të vonohet, për ndonjëherë nga këto arsye: a) dështimi i autoritetit kontraktues për të përmbushur

detyrimet e tij sipas kontratës; b) fuqisë madhore siç përcaktohet në Nenin 28 ", e vazhduar nga neni 28 paragrafi 1 i seksionit II të kontratës kornizë nën kushtet e përgjithshme që përkufizon "fuqinë madhore" dhe përcakton sjelljen procedurale të palëve në rast të një ngjarje të tillë. Draft kontrata në fjalë parasheh që "Force Majeure" nënkupton çrregullime industriale, çrregullime civile, luftëra, shpërthime, fatkeqësi natyrore, tërmete, zjarre, përmbytje, epidemi etj, të shkaktuara jo nga faji ose dështimi i palëve kontraktuese, të pamundura të parashikohen dhe përtej kontrollit të palëve të kontratës.

Për më tepër, Neni 28 paragrafi 2 parasheh që "Nëse ndodh një nga ngjarjet që përcaktojnë Force Majeure dhe kjo e bën të pamundur që operatori ekonomik të kryej zotimet dhe përgjegjësitë e parashikuara sipas kontratës, operatori ekonomik duhet të sigurojë sa më shpejt që të jetë e mundur për autoritetin kontraktues një deklaratë me shkrim me informacion të plotë në lidhje me ngjarjen. Në këtë rast zbatohen dispozitat e mëposhtme:

- i. Detyrimet dhe përgjegjësitë e operatorit ekonomik duhet të jenë në përputhje me kohën derisa të arrihet niveli i mundësisë objektive të përmbushjes së tyre.*
- ii. Gjatë pezullimit dhe në lidhje me punët e ndërprerë, të gjitha shpenzimet në lidhje me riparimin e pajisjeve teknike, akomodimin e personelit dhe shpenzimet e tjera të ngjashme, do të përballohen nga operatori ekonomik.*
- iii. Brenda 15 ditëve, duke llogaritur nga dita e ngjarjes që përcakton Force Majeure, menaxheri i projektit në bashkëpunim me autoritetin kontraktues do të vlerësojnë të gjitha punimet e përfunduara në mënyrë që autoriteti kontraktues të paguajë të kontraktuara.*
- iv. Afati i përmbushjes së detyrimeve të kontraktuara nga operatori ekonomik mund të zgjatet për një periudhë për aq kohë sa zgjat periudha e pezullimit.*
- v. Nëse operatori ekonomik për një kohë të gjatë nuk është në gjendje, për shkak të "Force Majeure", të përmbushë detyrat dhe përgjegjësitë e parapara me kontratë, autoriteti kontraktues brenda shtatë (7) ditëve mund të informojë me shkrim operatorin ekonomik për zgjidhjen e kontratës ".*

Nga sa u tha më sipër, nëse një palë nuk është në gjendje të përmbushë detyrimet e veta që burojnë nga kontrata e prokurimit publik për shkak të "force majeure", ajo nuk mund të përballlet me pasojat e mospërmbushjes së kontratës, mirëpo në këtë rast pala e cekur do të duhet të dëshmojë se janë përmbushur të gjitha kushtet për force majeure, si:

- a) rrethana të tilla nuk kanë ekzistuar në kohën e lidhjes së kontratës dhe paraqitja e tyre nuk ka mundur të parashikohet në bazë të arsyeshmërisë;

- b) për shkak të rrethanave, kontrata nuk mund të përmbushet në mënyrë objektive;
- c) pala që nuk arriti të përmbushë kontratën nuk ka mundur të kontrollojë ose parandalojë ato rrethana;
- d) pala nuk ka paraparë rrezikun e atyre rrethanave apo pasojave.

Në bazë të këtij koncepti pala kontraktuese duhet të dijë që: mospërmbushja e kushteve të kontratës duhet t'i njoftohet menjëherë palës tjetër kontraktuese dhe se përdorimi i "force majeure" është i një natyre të jashtëzakonshme. Palët mund të lirohen nga përgjegjësia vetëm për aq kohë sa është ndikuar në përmbushjen e kontratës.

Masat që duhet konsideruar nga Qeveria e Kosovës

- I. Klauzolat e përfundimit të kontratave të parapara në kontrata mund të konsiderohet se nuk kanë filluar ose nuk kanë hyrë në fuqi nëse ajo periudhë ka skaduar ndërmjet 11 Mars, 2020 dhe një muaj pas përfundimit të Qershorit 2020 apo më shumë, nëse zgjatet periudha kohore e urgjencës shëndetësore.
- II. Organizatat përfaqësuese të biznesit privat apo odat ekonomike mund të lëshojnë çertifikata të "Fuqisë Madhore" në mënyrë që të dëshmojnë ekzistencën e atyre rrethanave dhe kjo mund të jetë një argument i fortë në negociata. Kjo është një praktikë e krijuar dhe zbatuar në vende të tjera si Anglia, Bullgaria, Lituania, Kina, Ukraina, etj., ku çertifikata të tilla lëshohen nga odat ekonomike të atyre vendeve. Sekretariati i KKZHE-së do të krijojë një komitet nën Grupin Punues Legjislativ të udhëhequr nga Ministria e Drejtësisë dhe i ndjekur nga Gjykata Themelore në Prishtinë – Departamenti për çështje ekonomike dhe të gjitha palët e tjera të ndërlidhura për të koordinuar procesin e lëshimit të çertifikatave.
- III. Autoritetet kontraktuese dhe operatorët ekonomik mund të rishikojnë termat dhe kushtet e kontratave publike. Pasi të jenë identifikuar kushtet të cilat mund të jetë e vështirë ose e pamundur të zbatohen, palët mund të vlerësojnë përmbushjen dhe të vendosin për pezullimin, modifikimin apo ndryshimin e kontratës. Virusi Covid-19 ose karantina që rezulton prej tij mund të jenë arsye për të ndryshuar kontratën, por secili rast mund të konsiderohet në bazë të meritave të veta. Sidoqoftë, hapi thelbësor që rekomandohet të bëhet përpara se të inicohet procedura e modifikimit të kontratës është të kontaktohet paraprakisht autoriteti kontraktues ose operatori ekonomik, të gjenden qartë dhe në mënyrë të arsyeshme rrethanat që e bëjnë zbatimin e kontratës të vështirë apo edhe të pamundur, dhe të negociohet për zgjidhje, në përputhje me kërkesat e legjislacionit dhe interesave të dy palëve. Ndryshimi i kontratave mund të

lejohej nga legjislacioni në fuqi dhe nga Rregullat dhe Udhëzimet Operative të Prokurimit Publik.

- IV. Situata faktike e krijuar nga Covid-19 ose masat e miratuara nga qeveria qendrore apo autoritetet, mund t'i japin të drejtën operatorit ekonomik që të pezullojë detyrimet dhe përgjegjësitë e tij që burojnë nga kontrata e lidhur ndërmjet tij dhe autoritetit kontraktues, si dhe kontrata nuk mund të përfundojë për shkak të mospërbushjes së detyrimeve si pasojë e vonesës në punime. Në rrethana normale, kjo nuk do t'i nënshtrohej ndonjë lëshimi të mundshëm, mirëpo Qeveria e Kosovës për shkak të rrethanave të jo të zakonshme mund të veprojë si garantues për një periudhë shtesë kohore të dhënë, deri në fund të qershorit, 2020 ose më shumë nëse zgjatet periudha kohore e urgjencës shëndetësore.
- V. Gjykatat dhe Qendrat e Arbitrazhit mund të kenë parasysh parimin e "force majeure/fuqisë madhore" si dhe parimin e zgjidhjes ose revidimit të kontratës për shkak të rrethanave të ndryshuara dhe pamundësisë së përbushjes, në momentin e zgjidhjes së kontesteve komerciale ndërmjet bizneseve private dhe ndërmjet Autoritetit Publik dhe bizneseve private.
- VI. Sa i përket Kontratave të Sektorit Publik, ndëshkimet të kontraktuara për vonesë nuk mund të zbatohen gjatë pandemisë dhe afatet e pranuar nga kontrata mund të zgjaten deri pas përfundimit të qershorit 2020 ose më shumë nëse zgjatet periudha kohore e urgjencës shëndetësore.
- VII. Pezullimi i kontratave për shërbimet e vazhdueshme komunale, shërbimet e tjera komunale që nuk mund të kryhen si rezultat i Covid-19 apo masave të miratuara nga qeveria ose autoritetet komunale dhe të njëjtat të vazhdojnë pas fundit të muajit qershor 2020.
- VIII. Marr parasysh që Këshilli Gjyqësor i Kosovës ka vendosur mbylljen e gjykatës për publikun deri në njoftimin e mëtejshëm me përjashtimin e shërbimeve emergjente dhe ka ndërmarrë disa masa të tjera për punonjësit e gjykatës në përputhje me masat e miratuara nga Qeveria e Kosovës. Megjithatë të gjithë duhet të jenë të kujdesshëm në lidhje me afatet e parashkrimit, ekzekutimin e vendimeve / aktgjykimeve, caktimin e seancave dhe dërgimin e ftesës për palët, pasi ato paraqesin problemin kryesor për situatën aktuale.

Procedura e Falimentimit

Përhapja e përshpejtuar e Covid-19, ndikon që përditshmëria jonë të çrregullohet. Ndikimet negative janë duke u thelluar për shumicën dërrmuese të bizneseve dhe industrive të ndryshme. Në aspektin global, shumë kompani me aktivitete si: transporti tokësor, turizmi, udhëtimi ajror, hotelieri, restorante dhe kafiteri, transporti detar, ndërtimtari janë nga sektorët më të prekura. Ndërsa, në vendin tonë ndër sektorët më të prekur janë: ndërtimtaria, gastronomia, tregtia me pakicë, transporti tokësor dhe ajror i udhëtarëve, turizmi, etj. Ka një ulje të kërkesave për mallra të caktuara, si ato jo-ushqimore dhe një probabilitet të lartë që kompanitë të pezullojnë/largojnë nga puna punonjësit, në mënyrë që të zbusin një ulje të konsiderueshme të ardhurave.

Kërcënimi më i madh për ekonominë është që bizneset si pasojë e paaftësisë paguese të mos arrijnë të kryejnë pagesat dhe t'i nënshtrohen procedurës së falimentimit. Qeveritë dhe bankat qendrore në të gjithë botën kanë miratuar masa ekonomike për të mbështetur më tutje bizneset dhe për të zbutur çrregullimin ekonomik të shkaktuar nga pandemia. Disa juridiksione tashmë kanë ndërmarrë hapa për të ndryshuar, plotësuar dhe miratuar ligjet për falimentimin duke marrë parasysh pandeminë Covid-19, në anën tjetër gjersa situata po vazhdon të përkeqësohet, për një numër të konsiderueshëm të kompanive do të jetë i pashmangshëm kalimi nëpër procedura të ristrukturimit dhe falimentimit.

Sa i përket kompanive në vendin tonë, ato gjithashtu po kalojnë një periudhë të vështirë financiare. Rrjedhimisht, Qeveria e Kosovës ka ndërmarrë masa të ndryshme për të lehtësuar vështirësitë e tyre, nëse pandemia zgjat deri në fund të qershorit apo më tutje. Mirëpo, pavarësisht masave të ndërmarra nga ana e Qeverisë, kjo krizë ekonomike paraqet një kërcënim për mbijetesën e bizneseve, duke shkaktuar humbjen e aftësisë paguese të tyre dhe pamundësinë e tyre të përmbushin detyrimet e kontraktuara. Kështu që, për bizneset nevojitet një strategji e mirë e daljes nga kjo krizë, duke pasur parasysh mekanizmat alternative të zgjidhjes së kontesteve dhe në fund inicimin e procedurës së riorganizimit ose likuidimit të tyre.

Para se palët të iniciojnë procedurë të falimentimit ndaj debitorit, ato është mirë të shqyrtojnë mundësinë e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve të tyre duke shfrytëzuar mekanizmat alternativ jashtëgjyqësor, siç është ndërmjetësimi i cili rregullohet me Ligjin nr. 06/L-009 për Ndërmjetësimin. Mirëpo, palët mund të propozojnë zgjidhjen e kontestit

të tyre përmes ndërmjetësimit edhe gjatë procedurës së iniciuar të falimentimit dhe marrëveshja me shkrim e palëve e arritur përmes ndërmjetësimit i dërgohet gjykatës për aprovim, e cila pas aprovimit ka fuqinë e dokumentit përmbarues sipas ligjit përkatës për procedurën përmbarimore. Në rast se ndërmjetësimi ndërmjet palëve dështon ose palët nuk dëshirojnë të shfrytëzojnë një mekanizëm të tillë për zgjidhjen e kontestit ndërmjet tyre, atëherë debitori ose kreditori mund të i drejtohen gjykatës me kërkesë për inicimin e procedurës së falimentimit. Procedura e riorganizimit si pjesë e falimentimit mund t'u ofrojë bizneseve në vështirësi një mbrojtje nga kreditorët e tyre, duke siguruar vazhdimësinë e aktivitetit të tyre.

Në Kosovë falimentimi i shoqërive tregtare rregullohet me Ligjin Nr. 05/L-083 për Falimentimin. Në bazë të ligjit, procedura e falimentimit e një ndërmarrjeje përfshinë procedurën e riorganizimit dhe likuidimit. Në procedurën e riorganizimit, debitori është përfaqësues i pasurisë falimentuese kur vepron si debitor në posedim ose Administratori i falimentimit në rastet kur gjykata emëron një të tillë, ndërsa në procedurën e likuidimit përfaqësues i pasurisë do të jetë Administratori i falimentimit.

Procedura e falimentimit përfshinë në vete procedurën vullnetare të iniciuar nga debitori i cili paraqet kërkesë vullnetare për riorganizim ose likuidim dhe falimentimin e detyrueshëm të iniciuar nga kreditori i cili parashtron kërkesë për falimentim.

Procedura vullnetare e falimentimit inicohet nga debitori përmes paraqitjes së kërkesës për riorganizim ose likuidim dhe rasti hapet në datën kur debitori vullnetarisht dorëzon kërkesën e tillë.

Procedura e detyrueshme e falimentimit inicohet nga dy ose më shumë kreditorë që paraqesin një kërkesë për të nis një procedurë falimenti kundër debitorit dhe rasti hapet në datën kur gjykata merr vendimin mbi kërkesën jovullnetare të kreditorit. Në mënyrë që kreditori të ketë të drejtë të kërkojë inicimin e procedurës së falimentimit, borxhi i debitorit ndaj secilit kreditor duhet të jetë minimumi 3,000.00 €, secilit detyrim duhet t'i ketë kaluar afati i pagesës prej të paktën nëntëdhjetë (90) ditë dhe nëse debitori nuk ka paguar borxhet e tij sipas afatit, si dhe totali i borxheve të papaguara ka tejkaluar shumën prej 5,000.00 €.

Qëllimi i debitorit për të iniciuar riorganizimin e biznesit të tij është ruajtja e aseteve të tij përmes këtij procesi. Kërkesa e paraqitur për inicim të procedurës së falimentimit vendos

automatikisht moratorium dhe urdhër ndalesë lidhur me: fillimin ose vazhdimin e çfarëdo veprimi gjyqësor, administrative të drejtuar ndaj aktiviteteve afariste të debitorit ose pronave të tij; përmbarimin e aktgjykimit të nxjerrë ndaj debitorit dhe pronave të tij para inicimit të procedurës së falimentimit; marrjes në posedim të pronave pjesë e pasurisë së falimentimit; çfarëdo kërkesë për shlyerje të borxhit drejtuar debitorit. Debitori në procedurë riorganizimi ka cilësinë e të ashtuquajturit debitor në posedim dhe mund të vazhdoj të drejtoj biznesin përmes menaxhmentit të tij. Debitori në posedim ka të drejtën ekskluzive të dorëzoj planin e riorganizimit në gjykatë, që është ndër dokumentet më të rëndësishme i cili duhet të dorëzohet në afat prej 120 ditëve nga hapja e rastit, afat i cili mund të zgjatet nga gjykata edhe për më së shumti 18 muaj. Nëse brenda afatit të paraparë debitori në posedim nuk e dorëzon planin e riorganizimit, atëherë ai mund të dorëzohet nga secila palë e interesuar për riorganizimin e debitorit. Plani i riorganizimit duhet të klasifikoj kreditorët në kategori të ndryshme, si: kreditorët e siguruar, kreditorët e pasiguruar dhe bartësit e ekuitetit. Plani i riorganizimit votohet nga kreditorët në mënyrën e paraparë dhe pastaj gjykata konfirmon atë vetëm nëse propozuesi i planit i dëshmon gjykatës se: plani i riorganizimit është në përputhje me ligjin; propozuesi ka propozuar planin në mirëbesim; plani i riorganizimit parasheh se secili kreditor ose bartës i ekuitetit i prekur nga plani do të pranojnë të paktën aq sa do të kishin pranuar në rastin kur debitorit do të shkonte në likuidim dhe metodat e implementimit të planit janë të përshtatshme. Me konfirmimin e planit të riorganizimit debitori lirohet nga çfarëdo kërkesë që ka mundur të krijohet apo ka ekzistuar para konfirmimit të planit, që të arrihet kjo debitori duhet të veprojë gjithmonë në bazë të kushteve të parapara në plan. Në të kundërtën pala e interesuar mund të kërkojë revokimin e konfirmimit të planit dhe rrjedhimisht procedura e riorganizimit mund të shndërrohet në likuidim me vendim të gjykatës, nëse pala e interesuar i dëshmon gjykatës në përputhje me nenin 83 të Ligjit për Falimentim. Mirëpo, nëse të gjitha obligimet e dala nga plani i riorganizimit konsiderohen të përmbushura, atëherë gjykata me aktvendim vendos mbylljen e rastit të riorganizimit.

Nisur nga më sipër, bizneset mund të kenë parasysh procedurën e riorganizimit të tyre si mundësi e riorganizimit të borxheve (rinegociimi i kushteve të detyrimeve me kreditorët) në mënyrë që të mbajnë pronësinë mbi asetet e tyre dhe të vazhdojnë me aktivitetet e tyre edhe gjatë riorganizimit.

Në procedurën e likuidimit për dallim nga ajo e riorganizimit, gjykata emëron Administratorin e falimentimit i cili është përfaqësues i pasurisë së falimentimit. Në këtë procedurë Administratori i falimentimit është përgjegjës për shitjen e asetëve të shoqërisë tregtare në procedurë të likuidimit apo pasurinë e debitorit që lidhet me afarizmin e tij, me qëllim të pagimit të detyrimeve të debitorit ndaj kreditorëve. Në procedurën e likuidimit, kompania nuk ka më të drejtë të disponoj më me pronën e saj, që në momentin e emërimit të Administratorit të likuidimit. Pas mbylljes së rastit, Administratori mbyllë biznesin dhe ndërprejë të gjitha aktivitetet afariste të debitorit.

Gjykata kompetente për procedurën e falimentimit në Kosovë është Gjykata Themelore e Prishtinës - Departamenti për Çështje Ekonomike i përbërë nga një gjykatës i vetëm që shqyrton një çështje falimentimi. Ligji parasheh të drejtën e palës së goditur me vendim të gjykatës kompetente që të parashtrij ankesë në Gjykatën e Apelit, Departamenti për Çështje Ekonomike, ndërsa sipas këtij ligji mjetet e jashtëzakonshme juridike nuk lejohen.

Masat e Falimentimit që duhet konsideruar nga Qeveria e Kosovës

- I. Qeveria mund të angazhohet drejtë zvogëlimit të rasteve të falimentimeve të ndërmarrjeve, të sigurojë që njerëzit kanë para dhe të vazhdojnë të shpenzojnë edhe nëse nuk punojnë, si dhe të rrisin investimet publike dhe shpenzimet e kujdesit shëndetësor.
- II. Qeveria mund të ndërmarrë masa për t'i mundësuar bizneseve në Kosovë që të kalojnë një proces shpëtimi ose riorganizimi dhe të vazhdojnë afarizmin, duke u dhënë atyre hapësirë dhe t'i ndihmojë ata që të shmangin vonesat e pagesave dhe të mbështesin bizneset e kërcënuara si rezultat i shpërthimit të pandemisë.
- III. Ministria e Drejtësisë mund të merr masa për të njoftuar se për shkak të disponueshmërisë së kufizuar të gjykatave dhe situatës aktuale në gjykatë, procedurat të falimentimit në vazhdim e sipër (d.m.th. procedura e riorganizimit, procedurat e likuidimit) duhet të shtyhen deri në fund të qershorit apo tutje nëse zgjatet periudha kohore e urgjencës shëndetësore.
- IV. Ministria e Drejtësisë mund të angazhohet në organizimin e kampanjave qëllim të informimit të publikut për mundësitë e shfrytëzimit të procesit të ndërmjetësimi. Të inkurajohet shfrytëzimi i mekanizmave tjerë ligjor jashtë gjyqësore, përkatësisht ndërmjetësimi me qëllim të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve ndërmjet bizneseve, i cili mekanizëm parashihet me Ligjin nr. 06/L-009 për Ndërmjetësimin.
- V. Të siguroj që kompanitë do të mund të mbijetojnë pa kaluar nëpër procedurë të falimentimit, përmes kushteve më të lehta të huazimit, ndoshta duke shtyrë edhe më tutje pagesat e taksave ose pagave, duke pezulluar pagesat e kredisë, ose duke ofruar

ndihmë të drejtpërdrejtë financiare, nëse është e nevojshme, deri në fund të qershorit ose tutje nëse zgjatet periudha kohore e urgjencës shëndetësore.

- VI. Të mbështesë kompanitë në atë mënyrë që të vazhdojnë të furnizohen nevojshëm, me energji, lëndë të parë, duke u përpjekur të shpëtojnë kompanitë deri në fund të qershorit, në mënyrë që menaxhmenti i bizneseve të vazhdoj punën pa kërcënimin e detyrimeve/borxheve.
- VII. Programet e huadhënies në shkallë të gjerë, përfshirë garancitë e pjeshme ose të plota të qeverisë për kreditë e përgatitura nga bankat për bizneset, në mënyrë që t'ju mundësojnë atyre punësimin e individëve dhe të mos falimentojnë dhe kështu të jenë në gjendje të rifillojnë aktivitetin pas përfundimit të pandemisë.
- VIII. Kërkesat e kreditorëve për likuidimin e detyrueshëm mund të mos lejohen deri në fund të qershorit apo deri sa të ketë mbaruar urgjenca shëndetësore. Prandaj, gjyqtarët mund të mos pranojnë për shqyrtim kërkesat për falimentim që janë ngritur brenda kësaj kohe.
- IX. Pezullimi nuk mund të parashihet për falimentime vullnetare nëse: *paaftësia paguese nuk ka ndodhur për shkak të ndikimeve të pandemisë Covid-19; ose nuk ka perspektivë për zgjidhjen e një paaftësie paguese ekzistuese*. Kjo mund të vërtetohet nga pasqyrat financiare të debitorëve.
- X. Gjithashtu procedura e përmbarimit mund të zhvillohet në atë mënyrë që pala të mos parashtroj dokumentet personalisht, por ajo të zhvillohet vetëm përmes depozitimit të dokumenteve në një zarf të mbyllur. Parlamenti i Kosovës mund të ndër marrë masat e nevojshme për të ndryshuar ligjin me qëllim që kreditorëve t'iu vështirësohet të vënë debitorët pranë falimentimit apo të planifikojë pezullimin e paraqitjes së kërkesës për falimentim, gjatë periudhës së pandemisë.

Sipas ligjit ekzistues, kreditorët mund të parashtrojnë kërkesë për falimentim nëse secilit detyrim i ka kaluar afati i pagesës prej të paktën nëntëdhjetë (90) ditë; nëse borxhi i debitorit ndaj secilit kreditor është 3,000.00 €; ose nëse totali i borxheve të papaguara tejkalon shumën 5,000.00 €. Shuma e borxhit si kusht për të filluar procedurën e falimentimit ndaj debitorit është shumë e ulët, veçanërisht në këtë situatë. Prandaj, Qeveria ose Parlamenti mund të gjejnë një mënyrë për të rritur shumën e përcaktuar me ligjin aktual, me qëllim që të mos lejojnë kreditorët të fillojnë një procedurë të detyrueshme të falimentimit ndaj debitorit, për një shumë të ulët të borxhit.

Duke mbajtur procedurat e falimentimit në minimum dhe punëtorët ende pjesë të bizneseve, falë pezullimit të përkohshëm të kontratave të tyre dhe masave të ndërmarra nga qeveria, aktiviteti biznesor duhet të rifillojë pasi që njerëzit tërheqin dhe kompanitë rifillojnë investimet të cilat janë shtyre si pasojë e pandemisë.